

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Frosina Sylejmani e Gani Avdiu anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësve N.S. dhe H.S. nga Prishtina, të cilët i përfaqëson A.K. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës SH.P.K. "NN" nga Prishtina, të cilën e përfaqëson A.A. avokat nga Prishtina, për kompensimin e dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.649/2014 të datës 07.07.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.09.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me miratimin e përsëritshëm të ankesës së të paditurës PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 649/14 i datës 07.07.2014 në pjesën që ka të bëjë me pagimin e rentës për paditësen H.S. dhe për këtë pjesë i kthehet në rivendosje gjykatës së shkallës së parë, ndërsa sa i përket pjesës tjetër të dispozitivit të aktgjykimit, ankesa e të paditurës REFUZOHET si e pa bazuar dhe aktgjykimi i atakuar me ankesë në këtë pjesë VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësve N.S. dhe H.S. nga Prishtina, si e bazuar dhe detyrohet e paditura SH.P.K. "NN" nga Prishtina, që në emër të kompensimit të dëmit material t'ia paguaj shumën dhe atë: në emër të dëmit material shumën e përgjithshme prej 18.242.99 € dhe atë: për fitimin e humbur shumën prej 8.700.65 €, për mallin dh pajisjet e shkatërruara 8.430 €, në emër të rentës mujore për H.S. prej dt.12.10.2008 e tutje në shumë prej 112.50 €, në emër të rentës mujore për N.S. prej datës 12.10.2008 e tutje në shumë prej 12.50 €, si dhe kamata deri me datë 31.03.2009 në shumë prej 362.34 €, detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj paditësit shumën prej 270 €. Refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit material dhe atë për mallin dhe pajisjet e shkatërruar shumën prej 2000 €, në emër të rentës mujore prej datës 15.03.2008 e deri me datë 12.10.2008, shumën prej 1.575 €.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plot të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar me ankesë ta ndryshoj, ashtu që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar, apo ankesa të miratohet si e bazuar dhe aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Pala paditëse nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësit kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë me datë 04.06.2008 për kompensim dëmi kundër të paditurës SH.P.K "NN" nga Prishtina, me të cilën kanë kërkuar që paditësve t'ia kompensoj dëmin jo material për humbjen e bashkëshortit – babait dhe atë për paditësen N.S. shumën prej 20.000 €, dhe për vajzën H.S. shumën prej 30.000 €, në emër të ngritjes së lapidarit dhe shpenzimet e varrimit në lartësi prej 6.000 €, dhe në emër të dëmtimit të lokalit shumën prej 2.542 €, si dhe në emër të ushqimisë, mbajtës së humbur shumën prej 21.000 €, në emër të rentës mujore humbjen e mbajtur duke u llogaritur nga data e shkakimit të aksidentit deri me hartimin e ekspertizës në shumë të përgjithshme prej 21.817.99 €, ndërsa nga data 31.03.2009 e deri sa të ekzistojnë kushtet për një pagesë të tillë, renta mujore për vajzën H.S. shumën prej 112.50 €, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankën afariste më tepër se një vit pa destinim të caktuar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë.

Nga shkresat lëndës gjithashtu, rezulton se, në këtë çështje së pari ka vendosur Gjykata Komunale në Prishtinë, e cila me aktgjykimin C.nr.1149/2008 të datës 08.06.2009, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve. Lidhur me këtë çështje më pas ka vendosur edhe Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.1488/2012 të datës 10.09.2013, ku kishte vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Pas ushtrimit të revizionit nga pala e paditur Gjykata Supreme e Kosovës, merr aktgjykim Rev.nr.12/2014 dhe në pikën III të aktgjykimit e pranon revizionin e të paditurës dhe e prish aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Komunale në Prishtinë në pjesën që i referohet kompensimit të dëmit material në shumë të përgjithshme prej 21.818.90 €, si dhe rentën mujore e gjykuar paditësen H.S. nga data 31.03.2009 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore dhe lënda në këtë pjesë është kthyer në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata Themelore në Prishtinë në vendosje të serishme ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se në pjesën vërtetuese, aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Kjo pasi që nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë dhënë arsye të plota dhe të kuptueshme për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështje kontestimore. Kolegji vlerëson se në këtë pjesë aktgjykimi i atakuar nuk përmban shkelje esenciale nga dispozitat e nenit 182 par.2 të LPK-së për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kolegji vlerëson se në procedurën para gjykatës së shkallës së parë, edhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë.

Lidhur me pjesën e kthyer në rigjykim, kolegji ka gjetur se në këtë pjesë gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë dhe masë të plotë dhe se edhe e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të gabuar. Gjykata e shkallës së parë ka bërë caktimin gjykimin lidhur me rentën në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi që në kohën kur paditëses i është shkaktuar dëmi material, paditësja H.S. ka qenë e mitur, e në bazë të certifikatës së lindës shihet se paditësja H.S. ka lindur me datë 10.02.1994, kurse tani ajo është e moshës madhore. Duke e gjykuar vetëm në bazë të kësaj, del qarte se gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të rentës nuk ka vërtetuar faktin se çfarë

moshe është paditësja H.S., afatin kohor të pagesës së rentës, nëse paditësja H.S. është studente dhe nëse e njëjta është e punësuar. Në rastin konkret kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se nuk është vepruar konform dispozitave ligjore dhe për këto arsyeje ka vendos që aktgjykimi i atakuar të priset dhe për këtë pjesë çështja të kthehet në rigjykim na gjykatën e shkallës së parë.

Në procedurë të serishme gjykata e shkallës së parë është e detyruar që t'i eliminoj të metat e theksuara, ashtu që të ketë parasysh të gjithë faktorët relevant të cilët kanë ndikim me rastin e caktimit të rentës dhe lartësisë së saj, të vlerësohet dhe përcaktohet në mënyrë të qartë harku kohor për të cilin paditëses H.S. mundet që t'i takojë renta dhe të jap arsye të mjaftueshme ligjore lidhur me caktimin e saj. Në këtë mënyrë pasi që të vërtetohet drejtë gjendja faktike dhe të bëhet aplikimi i të drejtës materiale të mund të nxjerrët një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje kontestimore.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1, pika c) dhe d), e lidhur me nenin 201 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4846/2014, me datë 17.09.2018.

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj, d.v.